

V E N D I M
Nr.405, datë 15.8.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË
30.5.1994 “PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHTETIT NGA
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”**

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994, pika 4 ndryshohet si vijon:

“Mjetet e punës dhe të prodhimit, mjetet e transportit, karburantet e lubrifikantet, gruri si dhe prodhimet prej ari, argjendi e platini bëhen objekt shitjeje ose transferimi pa pagesë në institucione me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Lëndët e para, materialet, pjesët e ndërrimit dhe produktet e gatshme bëhen objekt shitjeje sipas procedurave të deritanishme. Shitja bëhet sipas dispozitave në fuqi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi